



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHITIME**  
Nr.01-060/01-21266/21 datë:18.08.2021



Npi – 01/223 Datë: 27.08.2021

Bazuar në nenin 12.2 pika (d) si dhe nenin 40.2 pika (c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenin 5 të Ligjit për Buxhetin e Rishikuar Nr.07/L-14; Udhëzimi Administrativ 06/2019 për kriteret përzgjedhëse të projekteve kapitale, si dhe mbi bazën e prezentimit nga Zyra Komunale për Financa të Propozim-Vendimit për destinimin e rezervës buxhetore, në emërtimin e projekteve kapitale, Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 27.08.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËR TRANSFERIN E MJETEVE FINANCIARE NGA KATEGORIA E REZERVËS  
BUXHETORE NË PROJEKTE KAPITALE**

**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -VIII- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më: 27.08.2021 me shumicën e votave aprovoi, vendimin për transferin (bartjen) e mjeteve financiare nga kategoria e rezervës buxhetore komunale, në riemërtimin e projekteve kapitale, sipas tabelës në vijim:

| Nr.                                                 | Emërtimi i Projektit                                                                                                                                                 | Burimi i<br>Financimit | Planifikimi   | Parashikimi    | Parashikimi    |
|-----------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|---------------|----------------|----------------|
|                                                     |                                                                                                                                                                      |                        | 2021          | 2022           | 2023           |
| 1                                                   | Rregullimi i shtigjeve për ciklizëm në fshatin Mollopoc                                                                                                              | 21-THV                 | 12,000        | 10,000         | -              |
| <b>Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik – Totali:</b> |                                                                                                                                                                      |                        | <b>12,000</b> | <b>10,000</b>  | <b>-</b>       |
| 2                                                   | Rregullimi i shtratit të Lumit Shtimjanja                                                                                                                            | 10-GQ                  | 15,000        | 30,000         | 240,051        |
| 3                                                   | Rregullimi i rrugëve dhe rrjetit të kanalizimit në Rr. "Adem Jashari" dhe Rr. "Komandant Kumanova" Shtime                                                            | 10-GQ                  | 20,810        | 20,000         | -              |
| 4                                                   | Rregullimi dhe zgjerimi i Urave në fshatrat Rashincë dhe Carralevë                                                                                                   | 10-GQ                  | -             | 20,000         | 70,000         |
| <b>Planifikim Urban – Totali:</b>                   |                                                                                                                                                                      |                        | <b>35,810</b> | <b>70,000</b>  | <b>310,051</b> |
| 5                                                   | Rregullimi i ndriçimit publik në fushat sportive në fshatrat: Muzeqinë, Godanc i epërm, Godanc i poshtëm, Pjetërshticë, si dhe dy fushat te Qendra Rinore në Shtime. | 10-GQ                  | 18,000        | 58,000         | -              |
| <b>Kultura dhe Sporti – Totali:</b>                 |                                                                                                                                                                      |                        | <b>18,000</b> | <b>58,000</b>  | <b>-</b>       |
| <b>Buxheti i Planifikuar – Totali:</b>              |                                                                                                                                                                      |                        | <b>65,810</b> | <b>138,000</b> | <b>310,051</b> |

**II**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

**III**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal, Ministrisë për Financa, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj